

# “KISHA E SHËN KOLLIT” SHELCAN- ELBASAN



RELACION  
TEKNIK

TIRANË 2022

MIRATOHET:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

Ark. Ronela Çuku

Ark. Katerina Margariti

Ing. Denisa Shehu

Ark. Joli Mitrojorgji

Sekretari i  
KKTKM-së

RUDINA ZOTO



## Përbledhja

VENDNDODHJA .....	2
ANALIZA HISTORIKO ARKITEKTONIKE E MONUMENTIT .....	2
NDËRHYRJET NDËR VITE ( ndërhyrje në arkitekturë).....	5
Në dojsen e arkivës së IMK-së gjejmë disa projte te hartuara dhe zbatuara nga IMK;.....	6
Puminet restauruese të kryera në vitet 1983;.....	6
Puminet restauruese të kryera në nëntor të vitit 198ë;.....	6
Puminet restauruese të kryera në nëntor të vitit 1988-89;.....	7
GJENDJA EKZISTUESE .....	12
Naosi dhe absida .....	12
Hajatai jugor.....	13
Hajatai perëndimor .....	15
Sistemim i oborrit .....	15

## VENDNDODHJA

Kisha e Shën Kollit ndodhet në qendër të fshatit Shelcan, të njësisë administrative Gjinar, në rrethin e Elbasanit.

Kisha është shpallur monument kulture i kategoris së I me vendim të “Institutit të Shkencave” Nr. 95-datë 16.10.1948, me vendim të “Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës” Nr. 6- datë 15.01.1963, me vendim të “Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kultures” Nr. 68-ë-datë 30.05.19ë0 dhe me vendim të “Ministria e Arsimit dhe c Kulturës” Nr. 1886 - datë 10.06.19ë3.



Fig. 1. Orthophoto - Planvendosja e Kishës në fshatin Shelcan

## ANALIZA HISTORIKO ARKITEKTIONIKE E MONUMENTIT

Një nga ndërtimet që ruan pikturën e Onufrit në vendin tonë është edhe kisha e Shën Kollit në fshatin Shelcan të komunës së Gjinarit, Elbasan. Në kohën e pikturimit nga Onifri, kisha është rindërtuar. Pjesa e vjetër e saj është një ndërtim i periudhës së parapushtimit turk që për nga teknika e ndërtimit mund të dotohet si e shek.XVI. Në planimetri objekti është drejtkëndësh, me përmasa 4.80-11.60 m, që në shek. XIX i është shtuar hajati 2 katësh, ndërtuar me mur guri (aktualisht hajati është 1 katësh mbuluar me çati një ujëse). Ndërtimit të vjetër i takon me siguri faqia lindre e ndërtuar me gurë dhe tulla me teknikën e njobur të kluasonazhit, me dy e deri në tre reshta horizontale tullash, dhe me dy tulla të vendosura vertiklisht ndërmjet gurëve. I tille duket se është edhe muri verior, ndërsa dy muret e tjera, jugor e perëndimori, janë të periudhës së rindërtimit dhe të pikturimit nga Onifri, që siç ka rezultuar nga studimet

e historianeve të artit duhet të jetë përpara vitit 1554. Kësaj periudhe i takon edhe ikonostasi prej muri me dy hyrje, në anën më nga veriu dhe në qendër me tipologjinë që gjen përhapje në fshatin Valshë të njësisë administrative Gjinar-Elbasan, e gjetkë. Në kishë hyhet nga porta e vendosur në anën perëndimore, ndërsa për ndriçimin ka edhe dritare dyshe në anën jugore, kolona e së ciles duket se është nga ndërtimi i vjetër.

E parë si kishë njënefeshe, kjo është relativiste e madhe, sepse siç duket të këtij tipi janë kapelat ose parakliset, duke përbërë një mjeshtësi, të cilin afresket e Onufrit e vlerësojnë së tepërm.



*Fig. 2. Pamje e fasadës lindore të kishës*



*Fig. 3. Pamje e fasadës veriore të kishës*



*Fig. 4. Pamje e fasadës perëndimore të kishës*



*Fig. 5. Pamje e fasadës jugore të kishës*

## NDËRHYRJET NDËR VITE ( ndërhyrje në arkitekturë)

Që nga shpallja monument kulture i kategoris së I i këtij objekti, janë hartuar dhe zbatuar disa projekte restaurimi nga specialistë të IMK-së. Në këtë fotografi të realizuar para viteve 80, shihet qartë se kisha ka patur të dy hajatët të mbuluar me çati. Çatia e hajati jugor është zgjatimi i çatisë së naosit dhe është i mbuluar pjesërishtë më tjegulla dhe pjesërishtëme rrasha guri (mendohet që më parë gjith çatia ka qenë e mbuluar me rrasha guri). Hajati perëndimor ka qenë dy katësh dhe i mbuluar nga një çati 4 ujëseme një lartësi që shkontë derl në nivelin më të lartë të frontonit përendimor të naosit. Kjo çati ka qenë e mbuluar me tjegulla vendi. Streha e të dyja hajatëve ka qenë e dalë rreth 40-50cm. Kisha ka patur edhe një kambanare të pozicionuar në qoshen jug-perëndimore të hajatit perëndimor, të distancuar nga muri i hajatit. Kambanarja është një ndërtim me murë guri dhe breza druri ( në lartësi të barazlarguar nga njëri tjetri) më bazë katrore dhe lartësi sa hajati perëndimor. Katër përdhe i saj mund të arrihej nepërmjet tre këmbëve shkallë. Ky kat ka dy hapje një në anën lindore dhe tjetra në atë perëndimore, të mbuluar me qemer. Ndërsa katë më sipër ka patër hapje një në secilën fasadë të saj po ashtu të mbuluar me qemer dhe me tiranta metalike. Kambana ka qen varur në katin e sipërm dhe tundej nga prifti nepërmjet një litari që nga katë përdhe. Çatia e kambanës duket të jetë e mbuluar me llamarinë (ndërhyrje e mevonëshme).



Fig. 6. Foto e kishës realizuar në vitin 1961



*Fig. 6. Foto e kishës realizuar në vitin 1966*

*Nga krahasimi që mund ti bëjmë dy fotove mësipër mund të shikojmë që ndërmjet ketyre viteve 1961-66 janë kryer punime restauruese. Është krijuar një trotuar përgjat fasadës lindore për të larguar ujërat sipërfaqësor dhe një revizioni i çatisë. Çatia e hajatit jugor është mbuluar vetëm më tjegulla në 1966.*

*Në dojsen e arkivës së IMK-së gjemë disa projekte hartuara dhe zbatuara nga IMK;*

**Puminet restauruese të kryera në vitet 1983;**

*Gjatë kontrollit në terren ishtë konstatuar se gjendja konstruktive e kishës ishtë shumë e mirë si rezultat i punimeve të kryera pak kohë më parë. Fasada jugore e saj kishte probleme me lagështinë si rezultat i shtimit të papastërtive dhe vegetacionit në oborrin e kishës në këtë anë.*

*Puminet që janë propozuar dhe zbatuar konsistonin në largimin e lagështisë dhe pastrimin dhe sistemimin e oborrit:*

- *Ndërtimin e një muri guri ma llaç gëlqere*
- *Pastrimin e vegetacionit në oborrin jugor*
- *Germim nivelim terreni*

*Autor projekti- Ark. Reshat Gega*

**Puminet restauruese të kryera në nëntor të vitit 1986;**

*Puminet restauruese që janë propozuar dhe realizuar gjatë vitit 1986 janë:*

- Xhveshja e mureve të kishës nga suvatimet e vona. Pastrim i murit me gur dhe tulla nga llaçi në mënyrë mekanike me rrjet teli. Pasi është bërë hedja e suvasë është realizuar fugatim i murit.

- Nga ana lindore, rreth ëm. nga muri i kishës është realizuar një mur mbajtës, taracim me gjatësi 12m. dhe trashësi 40cm. si dhe lartësi rreth 1 m. për të penguar shkarjen e dherave në fasadën linore.
- Kryerja e një sbankimi dherash nga ana veriore.
- Vendosjen e ullukëve horizontal dhe vertikal prej llamarine, në fasadën veriore dhe jugore.
- Revizionim çatit.
- Realizimi i një kanali për largimin e ujerave sipërfaqësor në murin jugor të kishës (jo të avllisë-hajatit i cili ka qën i pa mbulur me çati në këtë kohë).
- Zvendësimi i tjegullave të thyera si në çatin e kishës ashtu edhe në mbulesën e murit rrethues të avllisë (hajatit).

*Autor projekti- Gjergj Frashëri*


**Puminet restauruese të kryera në nëntor të vitit 1988-89;**

Gjatë viteve 1988-89 është hartuar dhe zbatuar nga IMK një projekte restaurimi i ndarë në dy faza.

#### **Faza e I në vitin 1988**

Për mënjanimin e lagështisë së ngritjes kapilare dhe përrjedhojë edhe të asajë të kondesimit janë kryer këto punime:

- Realizimi i një drenazhi të madh në fasadën lindore, veriore dhe pjesërishtë jugore, të cilat sjellin në themelin e kishës ujërat nëntokësor me nivel të lartë ngjitur, për shkak të tërrenit kodrinor të ngritur (Fig. 8).



*Fig. 8. Detaj i drenazhit, projekt i hartuar nga autor Gjergj Frashëri, specialist i IMKsë, në vit 1988*

- Fillimisht është hapur një sondazh në pikën "B" (Fig.9), për të parë thellësin e themelit të murit lindor. Për këtë është prishur një pjesë e murit lindor të hajatit duke kaluar aty drenazhin. Pas realizimit të drenazhit ishte parashikuar që ndërtimi i murit do të kishtë një distancë nga muri i kishës prej 10cm (muri i hajatit nuk do mështetej në murin e kishës) përfundimisht lagështinë.  
*Shënim: hajati në këtë kohë nuk ka qenë i mbuluar me çati.*
  - Drenazhi ishtë parashikuar të realizohej sipas projektit (Fig.ë-8), me mur mbajtës, gjerësi 25cm, me tulla dhe llaç bastard, mbuluar me gurë zhavorri dhe dy tuba qeramike(40-50cm largë njëri tjeterit). Thellësia e drenazhit është përcaktuar në vend pas sondazhit të themelit, duke shkuar 50cm më poshtë themelit. Pjerrësia e drenazhit në fasadën lindore nga krahu jugor dhe verior është realizuar 4% dhe mandëj shkon 2%.
- Ndërtimi i një drenazhi të vogël, ishtë parashikuar të ndërtohej pasi të kishtë përfunduar drenazhi i madh. Funksioni i tij ishtë që të mbantë të thatë themelit e kishës.
- Fillimisht është bërë ulja e terrenit deri në 15 nën kuotën e dyshëmës së kishës.
  - Është hapur një kanal i cekët në formë gjysmë-kove. Pasi është vendosur një tubacion, me të njëjtën pjerrësi si drenazhi i madh, është bërë mbushja më gur zhavorri.
  - Pas realizimit të drenazhit është menduar ralizimi i një trotuar i cili do të bënte mbylljen nga sipër të murit të drenazhit të madh. Pjerrësia e tij do ishte e njëjtë me atë të drenazhit të madh përkatësisht 4% dhe 2%.




Fig. 9. Detaj i drenazhit, projekti i hartuar nga autor i Gjergj Frashëri, në vitin 1988


- Pasi është përfunduar drenazhi dhe trotuari është ribër sërisht muri lindori hajatit (Hajati është një ndërtim i vonë i Shek.XIX).
- Në këtë përiudhë kur janë kryer punimet restauruese muri i absidës ka qën edhe më problematik pësa i përket lagështisë. Për këtë arsy e është realizuar një revizionim i saj. Për të bërë një ajrosje më të mire të pjesës së sipërme të absidës është bërë një strukturë druri mbi mbulesën e absidës me binarë 3x5cm dhe vendosja e tjegullave të vëndit mbi to. Gjithashtu është realizuar edhe mbyllja me ulluk llamarine xingato e vendit të takimit të kësaj çatit me murin e kishës. E njëjtë teknik është përdorur edhe në krahun tjetër të frontonit, ku bashkohët çatia e naosit me murin lindor dhe përendimor.
- Gjatë këtyre punimeve është realizuar edhe revizionimi i mbulesës me rrasha guri të frontonit lindo dhe përendimor.
- Është bërë edhe çlirimi i derës në fasadën jugore të naosit nga tamponimi me mur guri, në mënyë që të bëhej e mundur zbutja e efekteve të kondënsimit (Fig.10).

*Autor projekti- Gjergj Frashëri dhe rilevues Agim Qyshtka*

#### Faza e II në vitin 1989

Konservimi i piktures murale nga dëmtimet e lagështisë (pas kryerjes së drenazhit) kërkonte edhe punimet në vazhdim:


- **Mbulimi me çati të thjeshtë (një ujësë) të hajatit jugore dhe perëndimor.** Mbulesa është realizuar thjeshtë vetëm më mahi 12x15 cm, pa trarë horizontël, me binarë 5x5 cm. Në anën jugor ka qenë parashikuar që çatia të ishtë vazhdim i çatisë së naosit (ashtu siç e shikojmë të ket qenë para se të rrëzohej (Fig.ë) ndërsa në anën perëndimore mahit do të mbështeten mbi murin e frontonit dike i hapur secilës nga një fole të cekët. Fuga gjatësore e frontonit dhe e eternitëve janë mbuluar me llaç bastard (çatia ka qene propozuar për tu mbuluar me eternit gje që nuk e shikojme të jet zbatuar (Fig.11). Në krahun jugor streha e çatisë parashikohet të dalë 50cm, duke bërë një gërmim në tokë dhe një kanal të cekët (rreth 30cm të thellë) për largimin e ujërave të shiut që vijën nga çatia. Në fasadën përendimore streha shkon 20cm (pa kanal) (Fig.10).
- **Rimbulimi i kallkanëve të frontoneve.** Para ndërryrjeve kallkanët e frontoneve kanë qenë të mbuluar me rrasha guri por pa strehë. Duke mos e siguruar infiltrimin e ujerave të shirave. Kjo ka qenë edhe një nga arsyet që absida ka shumë lagështi në ambjentin e brendëshëm. Autori shprehet se “Duke qenë të detyruar, që ato formalishtë të janë gjithnjë, të mbuluar me rrasha guri ( gjurmë origjinale e mbulesës së kishës) hidroizolimi do të bëhet në këtë mënyr”; Është hëqur shtresa e rrasave është realizuar një nivelim me llaç bastard mbi korrnizën e frontonit mbi të cilin janë ngjitur fletët e eterniti me dalje rreth 20 cm nga të dyja anët si streh. Mbi fletët e eternitit janë fiksuar rrasat e gurit me llaç bastard në gjerësin e murit të frontonit. Rrasat kanë shërbyer për të mbajtu fletët e eternitit dhe për të trëguar gjurmet origjinale të mbulimit (Fig.10).



*Fig. 10. Detaj i mbulimit të çatisës, projekt i hartuar nga autor i Gjergj Frashëri, në viti 1989*

- Zgjatja e strehës në anën veriore dhe risuvatimi i murit të kishës në këtë anë (Fig.11-12). Prezenca e lagështisë në afresk, në mesin e murit verior ka bërë që të propozohet dhe zbatohet zgjatja e strehës së çatisë në anë veriore. Zgjatja e kësaj strehe ka patur për qëllim derdhjen e ujërave të çatisë në drenazhin e madh dhe jo mbi trotuar. Nga ana tjetër për shkak të boshlliqeve që janë konstatuar në strukturën e këtij muri, përvèç zgjatjes së strëhës që do të largojoj ujin e shiut që vjen direkt mbi fasadë është propozuar edhe risuvatimi i tij ( ndërhyrje kjo që sot nuk e shikojmë që të jëtë zbatuar). Ky mur ka qenë i suvatuar para së të hartohej projekt i për restaurimin e kishës në këto vitë. Autori i projektit shprehet se suvaja është hequr për të verifikuar dekorin prej tulle.

Zgjatja e strehës është realizuar me anë të bishtave 5xëcm si zgjatim i mahive të naosit (por ë-8cm më poshtë për ti lënë hapësirë arka druri 5x3cm). Bishtat e rinjë janë mbështetur në kushekë druri 5x5cm, të vendosur 45%. Mbulesa ka qenë e parashikuar me eternit (gië të cilën nuk e shikojmë të jët zbatuar) duke u rakorduar me rreshtin e fundit të tjegullave të çatisë ekzistuese të naosit.



*Fig. 11. Fasda jugore dhe pjesërishtë lindore e kishës pas restaurimit në viti 1990*



*Fig. 12. Fasda veriore, zgjatimi strehës dhe lealizimi i trotuarit, pas restaurimit në vitin 1990*

- **Rindërtim dyersh.** Për të realizuar zbutjen e ndryshimit të tëmperaturës të ambientit të brendëshëm dhe atij të jashtëm, janë realizuar disa ndërhyrje duke lënë dritaret dhe dyert e hajatit vetëm më kangjella hekuri dhe rrjet teli. Frëngjia e adsidës dhe dritaret e naosit do të ndohmojnë për ventilimin e kishës. Në fazën e parë të projektit është hapur dera e fasadës jugore të naosit e cila në këtë projekt është paisur me derë druri njëflegreshe më hapje nga brënda(Fig.10). Në këtë projëkt ka qenë e parashikuar që të duja dyert e naosit nga ana e jashtëme të paiseshin me dyer hekuri transparente me hapje nga jasht (kjo ndërhyrje nuk është implementuar).

- Për qëllime studimi në pjesën e sipërme të kodrës janë gërmuar dy pusë për të studiuar drejtimin e rrjedhës së ujërave nëntokësor.
- Në fazën e parë të projektit ishtë propozuar realizimi i një trotuari, i cili është implemtuar në fazën e dytë. Trotuari është realizuar në fasadën lindore dhe veriore ndëri në mbulimin e murit prej tulle të drenzahit (Fig. 12)
- Ai është realizuar me zhavorr të trashë llaç çimento dhe një shtresë pllakash guri nga sipër.
- Është realizuar spostimi i murit rrethues që ka shërbyer për pritjen dhe devijimin e ujërave të shiut që vijnë nga lart, krahу lindor.

*Autor projekti- Gjergj Frashëri dhe rilevues Mensur Bezhani*

## GJENDJA EKZISTUESE DHE NDERHYRJET E PROPOZUARA

### Naosi dhe absida

Kisha ndodhet në një gjendje relativisht të mirë, kjo edhe si pasojë e restaurimeve të kryera her pas here. Nga vëzhgimet e bëra ne tërrën u vërejtën dy çarje vertikale në muraturën e fasadës veriore. Nga specialistet e IMK u konstatua se kjo çarje është relativisht e vjetër. Në kreun e muraturës, në ndërrhyrjet restauruese të realizuara së fundmi, është realizuar një brez lidhës betoni në të cilin nuk vërehet vazhdimi i frakturave, kjo do të thotë që frakturat janë të hërvizuar dhe nuk janë më aktive.



*Foto 13. Pamje e fasadës veriore ku vërehen qarti çarjet vertikale në muraturë*

Problemet e konstatuara nga specialistët janë;

- Çatia duket të jetë në gjend të mirë konstruktive megjithatë duhet bërë një revizionim i saj.
- Degradimi, humbja apo prishje pjesore e ullukëve të shkarkimit ka bërë që ujërat e shiut të bien mbi muraturë dhe të shpëlajnë lidhësin e fugave.
- Për të zgjeruar sadopak çatin apo mbulimin e frontoneve nga të dyja anët në restaurimin e 1990 është përdorur fletë eterniti (një material shum i rrezikshëm dhe kancerogen per jetën e njeriut) dhe është mbuluar me rrasha guri. Kjo mulesë si dhe impluvet e llamarinës (shumë të dukshmë me sy të lire, mbi çati) ka ruajtu edhe infiltrimin e ujërave të shiut dhe degradimin e strukturës së çatisë.
- Në qoshen lindore të çatisë së zgjatur tëfasadës veriore, mungesa apo keqvedosja e impluveve të llamarinës ka shkaktuar degradimin dhe renien e strukturës bashk me tjegullat e çatisë së naosit.

Ndërhyrjet që propozohen në naos dhe absidë janë:

- Do të bëhet revisionimi i çatisë si dhe F.V e impluveve me letër katrame (katrama e cila nga njëre anë ka fletë metalike). Në të gjitha pjesët e çatisë ku takohet me murin e frontonit.
- F.V ullukësh shkarkimi, vertikal dhe horizontal në krahun verior (në krahun jugor çatia do pikoj mbi çatinë e hajatit jugor i cili do të ketë ullukët e shkarkimit në këtë krahë).
- Çmontimi i mbulesës së frontoneve, heqja e eterniti. Pasi të jët pastruar pjesa e frontonit do të mbulohet me tjegulla vendi me dy pjerresi dhe me kulm në qendër fiksuar me llaç çimento.
- Në fund të ullukut vertikal të shkarkimit do të realizohet një kunet (nëntokë) betoni shkarkimi me dimensione 40x40x40cm, e cila nepërmjet një tubi PVC do të largoj ujërat për në kanalin ekzistues kullues përgjat rrugës automobilistike.

### Hajatai jugor

- Si rezultat i infiltrimit të ujërave të shiut në pjesën ku bashkohet çatia e hajatit me muraturën e hajatit perëndimor, si pasoj e mos vendosjes së mirë të impluveve prej llamarine, ka shkaktuar degradimin e strukturës drusore të kësaj çatie. Degradimi i saj ka çuar në çedimin e çatisë dhe humbjen e vertikalitetit të murit jugor (në këtë zonë) të hajatit për nga jashtë deri në nivelin e poshtëm të dritareve.
- Muri i këtij hajati është i ndërtuar me gurë me një gjëresi prej 65cm dhe një lartësi rrëth 3m lidhur me llaç balte. Pas një vëzhgimi më të detajuar, u konstatua se brezat e drurit në

muraturë nuk janë të vazhduar dhe të lidhur me njeri tjetrin si në gjatësi ashtu edhe në gjerësin e murit (brezi i jashtëm me atë të brëndëshmin). Me sy mund të shikohet qartë se kjo muraturë ka vetëm një brez lidhës në nivelin e poshtëm të dritareve. Kjo ka bërë që muri deri në këtë nivel të jetë i qëndrueshëm, dhe në pjesën tjetër të jet i pa lidhur mire dhe të humb pjesërishtë vertikalitetin e tij si pasoj e forcës shtytese që vjen nga struktura e çatisë.

- Në murin e hajatit në krahun lindor, vërehet një çarje apo shkëputje e pjesës së muraturës me llaç cimento, (rindërtuar pasi është prishur gjatë punimeve restauruese në vitin 1990, për realizimin e drenazhit të madh) dhe murit më të hërvës më llaç balte. Mungesa e një brezi lidhës prej druri për të realizuar një lidhje më të konsoliduar ka bërë që këto dy pjesë të muraturës të shkëputen nga njëra tjetrën.
- Ne muraturen e krahut jugor të këtij hajati duket qartë se porta fillestare e hajatit është tamponuar me mur guri dhe brez lidhës dhe njëra nga dritaret në krahun lindort të portës është hapur si dër e re. Vazhdimi i brezit lidhës në këtë pjesë ka bërë që ky paret muri edhe pje i periudhave të ndryshme ndërtimi të mos kët probleme. Megjithëqfarë u citua më lart për muraturën e hajatit, përgjithësishtë struktura murale e tij është në gjendje të mirë konstruktive.
- Muratura vënde vënde ka degradim të lidhesit nëpër fuga.

Ndërhyrjet që propozohen në këtë hajat janë:

- Zbritje e tjegullave dhe stivoje e tyre në një vend të sigur për tu ripërdorur.
- Revizionimi i strukturës së çatisë, zvendësim i elementeve që kanë humbur funksionin me dru të stazhionuar dhe trajtura me anti mole dhe vaj lini.
- Vendosja e impluveve me letër katrame (katrama e cila nga njëri anë ka fletë metalike).
- Qeramosje tjegullave.
- Restaurim i murit lindor me tekniken shqep-qep dhe perfocimin e tij me brezë druri të stazhionuar dhe trajtura me anti mole dhe vaj lini.
- Do të bëhet pastrimi i fugave në mënyre mekanike, me furçdhe uji, dhe do të rifugatohet me llaç gëlqere.

## Hajatai perëndimor

- Muri perëndimor i hajatit, gjat gjithë lartësisë së dritares në krahun jugore ka një shkëputje të lehtë të paretit të brendëshëm dhe atij të jashtëm.
- Do të bëhet pastrimi i fugave në mënyre mekanike, me furçdhe uji, dhe do të rifugatohet me llaç gëlqere.
- Dyshemeja e hajatit (përvec rrugices nga hyrje e tij deri të hyrja e naosit) nuk është e shtruar, është më dhe natyror.
- Struktura e çatisë duket në gjendje të mire por ka nevojë për një revizionim.
- Mungojne ullukët e shkarkimit si ato horizontal ashtu edhe ato vertikal. Si pasoj ujërat që bien nga çatia kanë bërë zbankimin e dherave në mënyrë të vazhduar duke rrezikuar edhe zbulimin e themelive të hajatit. Kjo vërehet edhe nga krahasimi i fotografive (dokumenta arkivor IMK), në 1990 hyje në hajat nepërmjet 1 këmbë shkallësh ndërsa sot ka 3 këmbë shkallësh.

Ndërhyrjet që propozohen në hajatin perëndiom:

- Do të bëhet revizionimi i çatisë si dhe F.V e impluveve me letër katrame (katrama e cila nga njëri anë ka fletë metalike). Në të gjitha pjesët e çatisë ku takohet me murin e frontonit perëndimor.
- F.V ullukësh shkarkimi, vertikal dhe horizontal në krahun perëndimorr. Në fund të ullukëve vertikal të shkarkimit do të realizohet një kunetë (nëntokë) betoni shkarkimi me dimensione 40x40x40cm, e cila nepërmjet një tubi PVC do të largoj ujërat për në kanalin ekzistues kullues përgjat rrugës automobilistike.
- Shtrimi me pllaka guri në të thatë i gjith dyshemesë së hajatit.
- Qepje e dy paretëve të murit, tëk dritarja e hajatit me teknikën shqep-qep.

## Sistemim i oborrit

- Muri rrethues sidomos në anën vëriore dhe jugore është i degraduar dhe ka shkëputje të gurëve (muri është në të thatë).
- Kangjellat përreth kishës vende vende ka deformime dhe nevojë për lyerje me anti ndryshk.
- Rruga që nga rruga automobilistike e deri në hyrje të hajatit perëndimor është më dhe natyror.

Ndërhyrjet që propozohen në hajatin perëndiom:

- Shtrimi i rrugës nga rruga automobilistike e deri në hyrje të hajatit perëndimor me pllaka guri në të thatë.
- Konsolidimi i shkallëve prej guri, në hyrjen e oborrit.
- Restaurimi i murit rrethues me teknikën shqep-qep dhe konsolidimi i kreut me pllaka guri fiksuar me llaç çimento.
- Restaurimi i kängjellave si dhe lyerja e tyre me boje anti ndryshk.
- F.V dy stola prej druri para fasadës perëndimore.

## BIBLIOGRAFIA

Arkivi i IMK-së, Dosja Nr.336 *Dokumentacioni*: në arkivin e IMK-së ka dokumentacion grafik dhe fotografik për këtë kishë.

*Bibliografia:*

- Aleksandër Meksi "Arkitektura e ndërtimeve ku punoi dhe krijoj Onifri", "Vera të mjeshtërve tanë", Tiranë 1983.

Ronela  
cuku

Digitally signed by  
Ronela cuku  
Date: 2022.03.10  
12:28:46 +02'00'

